



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS

KRYETARI I KOMUNËS

01. nr. \_\_\_\_\_, më  
14-346/07-62132/20 20. 03. 2020

Në bazë të nenit 13, të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), dhe të nenit 53, të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, sipas detyrës zyrtare nxjerr këtë:

**URDHËRESË  
PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES SË AUTOMJETEVE NË PARKUN "GËRMIA"**

**I.**

NDALOHET qarkullimi i të gjitha automjeteve në drejtim të parkun "Gërmia", përveç automjeteve të banorëve të lagjes, Policisë së Kosovës, Drejtorisë së Inspektionit, KFOR-it, Hortikulturës dhe KRM "Pastrimi".

**II.**

Ndalesa sipas pikës I të kësaj urdhërese vlen për periudhën prej 21 mars 2020 deri më 22 mars 2020, dhe është vazhdimësi emasave që i ka ndërmarrë Komuna e Prishtinës për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19.

**III.**

Pika përfundimtare për ndalimin e lëvizjes e automjeteve përveç atyre të cekura në pikën 1 të këtij Vendimi, do të jetë nga udhëkryqi i Taukbahces në drejtim të Gerimës, ashtu që duhet të ndalohen edhe udhëkryqet tek lagja "Sofalia".

**IV.**

Personat të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj urdhërese do të gjobiten në bazë të legjislacionit në fuqi.

**IV.**

Për zbatimin e kësaj urdhërese kujdeset Drejtoria e Inspektionit.

**V.**

Zyra për marrëdhënie me publikun do t'i njoftojë qytetarët dhe subjektet e tjera për këtë urdhëresë, përmes mediave të shkruara dhe elektronike

**VI.**

Kjo urdhëresë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.

T'u dorzohet:

- Drejtorisë së Inspektionit;
- Policisë së Kosovës;
- Zyrës për marrëdhënie me publikun;
- Qendrës për shërbim me qytetar.

KRYETARI I KOMUNËS  
Shpend Ahmeti

